



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK**

VENDIM

Nr. 16, datë 08.04, 2019

MBI

**“MIRATIMIN PËR DEKLARIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE
TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR DHE
CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER, NË
FAKULTETIN E ARTIT SKENIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR VITIN
AKADEMIK 2019-2020”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pikën 3 të nenit 69 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe pasi shqyrtoi materialin mbi propozimet e Fakultetit të Artit Skenik, për deklarimin e numrit të kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë Bachelor dhe ciklit të dytë me kohë të plotë Master dhe pasi e diskutoi me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin për deklarimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, në Fakultetin e Artit Skenik të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2019-2020, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim ti dërgohet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë së bashku me deklarimin e kuotave për vitin akademik 2019-2020.

